



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 2 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 340 prot., datë 19.01.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në zbatim të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, aplikimi i shtesës për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet IT përgjegjës për sistemet informatike në institucionet e sistemit të drejtësisë parashikohet në lidhjen nr.3, pika 26, gërma ii, në të cilën citohet: “Pozicione IT përgjegjës për sistemet informatike në administratën e Kuvendit, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe drejtorisë përgjegjëse për fushën TIK në aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, në masën përkatësisht:

- 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “specialist”;
- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “përgjegjës sektori”;
- 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “drejtor drejtorie” apo “drejtor i përgjithshëm”.

Sa më sipër, në Gjykatat e të treja niveleve, në cilësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë, nëpunësit e teknologjisë së informacionit, përgjegjës për sistemet informatike, përfitojnë pagesën e shtesës për natyrë të veçantë pune, procedurë e cila zbatohet sipas efektit të VKM-së së sipërcituar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!